



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT

Nr. 10196 Prot.

Tiranë, më 22.11.2018

UDHËZIM

Nr. 14, datë 22.11.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 9.01.2018 "MBI
PËRDORIMIN E SISTEMIT DINAMIK PËR BLERJEN E BILETAVE TË
TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR DHE ZHVILLIMIN ME MJETE
ELEKTRONIKE" TË NDRYSHUAR**

Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 40/1, Kreu IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar,

UDHËZON:

1. Në Udhëzimin Nr. 4, datë 9.01.2018 "Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike" të ndryshuar, në formularët standardë bashkëlidhur këtij udhëzimi bëhet ky ndryshim:

"Në Formularin Nr. 4 "Formular për njoftimin e anulimit të sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar" hiqet pika 4 "Fondi limit".

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

